

Treguesit e realizimit të
buxhetit të Bashkisë Tiranë
për 4-mujorin 2022

	HYRJE	Fq.3
KAPITULLI I	Realizimi i shpenzimeve të Bashkisë Tiranë për 4 mujorin 2022	Fq.4
	Shpenzimet sipas programeve	Fq.6
	Shpenzimet sipas burimeve të financimit	Fq.7
	Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik	Fq.9
KAPITULLI II	Monitorimi i Shpenzimeve dhe Produkteve sipas programeve	Fq.13
KAPITULLI III	Ecuria e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitet 2015- 2021	Fq.49

RAPORT MONITORIMI
I
BASHKISË TIRANË PËR 4-MUJORIN 2022

HYRJE

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 “ Për Financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; udhëzimit plotësues nr. 4 datë 25.01.2021 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”; Udhëzimit nr. 22 dt 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; VKB nr. 166 datë 24.12.2021 ‘Për miratimin e PBA 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2022, (i ndryshuar), paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin 2022, duke analizuar performancën financiare në funksion të arritjes së objektivave dhe realizimit të shpenzimeve sipas programeve.

Raporti bazohet në të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet faktike dhe transfertat ndërqeveritare, duke ndjekur klasifikimin administrativ, ekonomik, funksional dhe sipas burimeve të financimit.

Transparenca mbi përdorimin e fondeve publike është e rëndësishme për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarrje dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve. Tashmë që nga viti 2015 zbatohet Reforma Administrative dhe Territoriale (RAT) dhe decentralizimit të funksioneve të reja.

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, me VKB nr. 18 datë 04.04.2022 të ardhurat e papërdorura të vitit Buxhetor 2021 trashëgohen në buxhetin e vitit 2022.

Informacioni i përcjellë në këtë raportim është realizuar jo vetëm nga raportet e tërhequra nga SIFQ (Sistemi i Informatik Financiar i Qeverisë) por dhe nga informacioni i përcjellë në mënyrë shkresore nga Drejtoritë e Bashkisë Tiranë dhe Institucionet e Varësisë të përfshira në këtë proces.

Bashkia Tiranë po vijon me likuidimet e angazhimeve të marra dhe ka vijuar evidentimin dhe përfshirjen në buxhet të detyrimeve të prapambetura nga viti 2021 sipas informacioneve të sjella edhe nga strukturat të cilat menaxhojnë funksionet e Bashkisë.

Nga ana tjetër dinamika me të cilën ecin punët në Bashkinë Tiranë kërkon jo vetëm rishikime të projekteve në vazhdim, por edhe kërkesa për të shtuar projekte dhe shpenzime të reja për të maksimizuar nevojat e Institucionit në funksion të qytetit.

KAPITULLI I

REALIZIMI

I

SHPENZIMEVE TË BASHKISË TIRANË PËR 4-MUJORIN 2021

Bashkia Tiranë gjatë kësaj periudhe, ka menaxhuar dhe realizuar shpenzime sipas 33 programeve buxhetore, Fondin Rezervë dhe Fondin e Kontigjencës , bazuar në funksionet bazë dhe të deleguara sipas ligjit për qeverisjen vendore, konkretisht:

1. Programi Planifikim, Menaxhim & Administrim
2. Programi Çështje Financiare & Fiskale
3. Programi Gjendja Civile
4. Programi Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm
5. Programi Shërbimet e Policisë Vendore
6. Programi Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile
7. Programi Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik
8. Programi Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi
9. Programi Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve
10. Programi Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit
11. Programi Administrimi i Pyjeve & Kullotave
12. Programi Rrjeti Rrugor
13. Programi Transporti Publik
14. Programi Projekte Zhvillimi
15. Programi Zhvillimi i Turizmit
16. Programi Menaxhim i Mbetjeve
17. Programi Programet e mbrojtjes së mjedisit
18. Programi Planifikim Urban Vendor
19. Programi Strehimi
20. Programi Programet e Zhvillimit
21. Programi Menaxhimi i mbetjeve urbane
22. Programi Shërbimet Publike Vendore
23. Programi Ndriçim Rrugësh
24. Programi Sport dhe Argetim
25. Programi Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore
26. Programi Arti dhe Kultura
27. Programi Arsimit Bazë përfshirë arsimin parashkollor
28. Programi Arsimit i Mesëm i Përgjithshëm
29. Programi Arsimit Profesional
30. Programi Kujdesi Social për personat e sëmurë & me aftësi të kufizuar
31. Programi Kujdesi Social për familjet & fëmijët
32. Programi Papunësia, Arsim & Aftësim Profesional
33. Programi Strehim Social
34. Fondi Rezervë
35. Fondi i Kontigjencës

Buxheti fillestar i Bashkisë Tiranë për vitin 2022 është 23,608,964,061 lekë. Kjo vlerë përfshin të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Donatorët.

Gjatë vitit 2022 kemi pasur rishikim të buxhetit me 3 (tre) vendime të Këshillit Bashkiak.

Referuar Akt-rakordimeve përfundimtare fondi i mbartur në total është në vlerën 5,274,288,403 lekë i përbërë: nga të ardhurat e mbartura dhe të papërdorura 3,606,092,031 lekë; nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme në shumën 1,643,211,738 lekë dhe nga donatorët në shumën 24,984,634 lekë.


Referuar Akt-rakordimit përfundimtar të fondit të rindërtimit vlera e mbartur është 5,349,010,561 lekë.

1. Çështje të rishpërndarjes së buxhetit gjatë periudhës

- Përfshirja e kërkesave dhe e detyrimeve të krijuara rishtazi në buxhetin e vitit 2021, për Aparatin e Bashkisë si dhe për të gjitha institucionet e varësisë së Bashkisë së Tiranës, si dhe sistemime në zërat e investimeve duke sjellë si rezultat shtesa, pakësime apo rishpërndarje fondesh si rezultat i dinamikës pas hapjes nga periudha e pandemisë.
- Fondet e trashëguara të rindërtimit nga viti 2021 përdoren për të njëjtin qëllim për të cilin janë akorduar bazuar në VKM-të e vitit 2022 si rindërtimi i objekteve arsimore, rindërtimi i banesave individuale, rindërtimi i infrastrukturës publike, rindërtimi i njësive të banimit ndërtesa (pallat) zona 5 Maji Kombinat, hartim i planeve të detajuara vendore, inspektim vlerësim dëmsh, hartim projekti të ndërhyrjeve rehabilituese si dhe Shpronësim Zhvillimi i Njesisë Administrative Vaqarr dhe Zall-Herr.
- Nga Drejtoritë e Përgjithshme janë paraqitur kërkesa për rialokime në buxhetin e vitit 2022 kryesisht në shtim plani për shpenzime operative, ndryshime emërtimesh, investime të reja, studim projekte dhe oponenca për objekte të reja ndërtimore etj.

2. Shpenzimet sipas programeve

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 Bashkisë Tiranë i ndarë sipas programeve paraqitet si vijon:



Siç vihet re, peshën më të madhe në planifikim e zënë:

- Programi i Shërbimeve Publike Vendore (15%)
- Programi i Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor (11%)
- Programi i Planifikimit Urban Vendor (10%)
- Programi i Rrjetit Rrugor (9%)
- Programi i Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit (8%)
- Programet e Zhvillimit (7%)
- Programi i Menaxhimit të Mbetjeve (6%)
- Programi i Arsimit të mesëm të përgjithshëm (5%)
- Programi i Kujdesit Social për familjet dhe fëmijet (4%)
- Programet e Tjera (25%)

3. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Në total Bashkia Tiranë ka një realizim prej 35% të planit 4-mujor 2022. Kjo vlerë përfshin të gjitha burimet e financimit.

Referuar klasifikimit ekonomik realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit janë realizuar me 78%,
- Shpenzimet operative me 42% dhe
- Shpenzimet kapitale me 20%.

Më poshtë paraqitet në mënyrë tabelare informacioni i mësipërm:

				në lekë	
Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %	
<i>Shpenzime personeli</i>	6,979,216,694	2,512,265,385	1,945,867,789.38	78%	
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	11,546,122,142	6,686,444,259	2,838,308,613.32	42%	
<i>Shpenzime kapitale</i>	19,143,470,464	10,325,580,296	2,091,186,767	20%	
Totali	37,668,809,300	19,524,289,940	6,875,363,169.70	35%	


4. Shpenzimet sipas burimeve të financimit

Shpenzimet sipas burimeve të financimit për 4-mujor 2022, paraqiten si më poshtë:

					në lekë	
Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi 4M ne %	struktura vjetore	
<i>Te ardhura BT</i>	23,413,345,031	7,804,711,909	3,119,757,963	40%	62%	
<i>Transferta e Pakushtezuar +Sektoriale</i>	5,436,099,538	2,961,395,817	1,128,379,222	38%	14%	
<i>Transferta e Pakushtezuar Rindertimi</i>	5,606,715,561	5,606,715,561	1,391,119,929	25%	15%	
<i>Transferta e Kushtezuar</i>	3,177,650,695	3,146,077,020	1,234,755,142	39%	8%	
<i>Donacione</i>	34,327,889	4,719,047	1,350,913	29%	0%	
<i>Financime te Huaja</i>	670,586	670,586	-		0%	
Totali	37,668,809,300	19,524,289,940	6,875,363,170	35%	100%	

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme, burimi kryesor i financimit për buxhetin 4-mujor 2022 vijon të jetë nga të ardhurat e Bashkisë, në vlerën faktike 3,119,757,963 lekë e cila përbën 62% të të ardhurave totale faktike. Fondet e Pakushtëzuara dhe Sektoriale zënë 14% të burimeve të financimit të

planifikuara, Fondet e Pakushtëzuara Rindertimi zënë 15% të burimeve të financimit të planifikuara, Fondet e Kushtëzuara zënë 9% të strukturës së burimeve të financimit, sipas grafikut më poshtë:



5. Shpenzimet sipas klasifikimit në programe

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e shpenzimeve të 4-mujorit 2022 në bazë programesh:

në lekë

Emertimi	Plan 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	% ndaj planit 4M	struktura/plani vjetor
01110 Planifikim, Menaxhim & Administrim	3,138,546,869	1,256,616,270	799,566,095	64%	8%
01120 Ceshtje Financiare & Fiskale	350,990,358	118,000,000	87,458,093	74%	1%
01170 Gjendja Civile	46,721,675	17,990,000	17,323,721	96%	0%
03140 Sherbimet e Policise Vendore	601,964,339	176,700,000	156,532,027	89%	2%
03280 Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	1,247,241,916	937,449,738	68,045,350	7%	3%
04130 Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik	43,260,000	30,418,000	5,309,413	17%	0%
04160 Sherbimi I Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi	69,404,498	27,179,910	19,199,720	71%	0%
04220 Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve	294,175,879	110,328,414	56,264,562	51%	1%
04240 Menaxhim i Infrastruktures se Ujitjes & Kullimit	59,510,471	14,053,427	406,960	3%	0%
04260 Administrimi I Pyjeve & Kullotave	11,758,002	7,099,034	2,824,000	40%	0%
04520 Rrjeti Rrugor	3,446,093,680	1,168,360,521	304,004,619	26%	9%
04570 Transporti Publik	588,657,585	302,334,000	87,182,317	29%	2%
04740 Projekte Zhvillimi	263,554,106	60,920,586		0%	1%

04760	Zhvillimi I Turizmit	20,152,950	12,152,950	1,752,500	14%	0%
05100	Menaxhim I Mbetjeve	2,085,858,518	1,075,758,518	437,613,086	41%	6%
05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	9,837,947	5,837,947	3,782,296	65%	0%
06140	Planifikim Urban Vendor	3,897,345,085	1,787,410,693	314,119,988	18%	10%
06190	Strehimi	200,301,000	200,301,000	196,876,000	98%	1%
06210	Programet e Zhvillimit	2,676,658,562	2,663,158,562	1,073,250,807	40%	7%
06220	Menaxhimi I mbetjeve urbane	180,000,000	180,000,000	178,309,966	99%	0%
06260	Sherbimet Publike Vendore	5,478,655,156	1,983,327,353	611,268,817	31%	15%
06440	Ndricim Rrugesh	384,867,082	234,867,082	87,621,516	37%	1%
08130	Sport dhe Argetim	663,356,743	394,561,194	133,646,376	34%	2%
08220	Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	723,497,221	344,780,740	147,614,974	43%	2%
08230	Arti dhe Kultura	1,347,597,000	1,347,597,000	-	0%	4%
09120	Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor	4,009,219,197	2,408,858,838	668,704,901	28%	11%
09230	Arsimi I mesem I pergjithshem	1,984,540,011	864,692,315	450,775,087	52%	5%
09240	Arsimi profesional	178,687,642	61,522,730	30,948,005	50%	0%
10140	Kujdesi Social per personat e semure & me aftesi te kufizuar	17,070,000	6,000,000	1,582,350	26%	0%
10430	Kujdesi Social per familjet & femijet	1,651,639,418	1,465,813,912	890,931,804	61%	4%
10550	Papunesia, Arsim & Aftesim profesional	35,000,000	25,000,000	11,950,000	48%	0%
10661	Strehimi Social	1,272,646,390	155,199,206	30,497,819	20%	3%
04910	Fondi Rezerve	450,000,000	35,000,000	-	0%	1%
04940	Fondi I Kontigjences	240,000,000	45,000,000	-	0%	1%
	TOTAL	37,668,809,300	19,524,289,940	6,875,363,170	35%	100%

-Programi Arsim Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor i cili përbën 11% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 28% të 4-mujorit 2022.

- Programet e Zhvillimit i cili përbën 7% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 40% të 4-mujorit 2022.

- Programi i Shërbimeve Publike Vendore i cili përbën 15% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 11% të 4-mujorit 2022.

-Programi i Planifikimit Urban Vendor i cili përbën 10% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 18% të 4-mujorit 2022.

-Programi Planifikim, Menaxhim, Administrim i cili përbën 8% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 64% të 4-mujorit 2022.

6. Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik

Shpenzimet korente dhe kapitale për çdo funksion sipas programeve dhe nga të gjitha burimet pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

SHPENZIME KORENTE

SHPENZIME KAPITALE

	Emertimi	Plan 4M 2022	Fakti 4M 2022	%	Plan 2022	Fakti 4M 2022	%
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	1,146,239,516	756,784,839	66%	110,376,754	42,781,256	39%
01120	Ceshtje Financiare & Fiskale	103,000,000	87,458,093	85%	15,000,000	-	0%
01170	Gjendja Civile	17,990,000	17,323,721	96%	-	-	0%
03140	Sherbimet e Policise Vendore	172,200,000	156,532,027	91%	4,500,000	-	0%
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	842,449,738	67,999,634	8%	95,000,000	45,716	0%
04130	Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik	30,418,000	5,309,413	17%	-	-	0%
04160	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	21,996,070	19,199,720	87%	5,183,840	-	0%
04220	Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve	102,188,414	56,264,562	55%	8,140,000	-	0%
04240	Menaxhim i Infrastruktures se Ujitjes & Kullimit	14,053,427	406,960	3%	-	-	-
04260	Administrimi i Pyjeve & Kullotave	7,099,034	2,824,000	40%	-	-	-
04520	Rrjeti Rrugor	329,467,227	151,746,935	46%	838,893,294	152,257,684	18%
04570	Transporti Publik	218,700,000	75,005,517	34%	83,634,000	12,176,800	15%
04740	Projekte Zhvillimi	600,000	-	0%	60,320,586	-	0%
04760	Zhvillimi i Turizmit	12,152,950	1,752,500	14%	-	-	-
05100	Menaxhim i Mbetjeve	1,075,758,518	437,613,086	41%	-	-	-
05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	5,837,947	3,782,296	65%	-	-	-
06140	Planifikim Urban Vendor	72,209,500	50,177,403	69%	1,715,201,193	263,942,585	15%
06190	Strehimi	200,301,000	196,876,000	98%	-	-	-
06210	Programet e Zhvillimit	70,665,715	25,048,439	35%	2,592,492,847	1,048,202,368	40%
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	180,000,000	178,309,966	99%	-	-	-
06260	Sherbimet Publike Vendore	459,233,304	323,860,996	71%	1,524,094,049	287,407,821	19%
06440	Ndricim Rrugesh	234,867,082	87,621,516	37%	-	-	-
08130	Sport dhe Argetim	382,628,526	133,616,376	35%	11,932,668	30,000	0%
08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	313,662,900	147,614,974	47%	31,117,840	-	0%
08230	Arti dhe Kultura	-	-	0%	1,347,597,000	-	0%
09120	Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor	921,643,292	556,450,918	60%	1,487,215,546	112,253,983	8%
09230	Arsimi i mesem i pergjithshem	475,563,175	282,174,258	59%	389,129,140	168,600,829	43%
09240	Arsimi profesional	59,522,730	30,948,005	52%	2,000,000	-	0%
10140	Kujdesi Social per personat e semure & me aftesi te kufizuar	6,000,000	1,582,350	26%	-	-	-
10430	Kujdesi Social per familjet & femijet	1,462,062,373	887,444,079	61%	3,751,539	3,487,725	93%

10550	<i>Papunesia, Arsim & Aftesim profesional</i>	25,000,000	11,950,000	48%	-	-	-
10661	<i>Strehimi Social</i>	155,199,206	30,497,819	20%	-	-	-
04910	<i>Fondi Rezerve</i>	35,000,000	-	0%	-	-	-
04940	<i>Fondi I Kontigjences</i>	45,000,000	-	0%	-	-	-
	TOTAL	9,198,709,644	4,784,176,403	52%	10,325,580,296	2,091,186,767	20%

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat duke iu referuar Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2022-2024 të miratuar me VKB nr. 166 datë 24.12.2021 dhe në vazhdim, planit për buxhetin vjetor të miratua me këtë vendim, si dhe për këtë periudhë 4-mujori 2022 planin dhe faktin. Kjo vlerë përfshin të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale.

në lekë

Emertimi	PBA fillestar 2022	Plan i rishikuar 2022	Plani 4 M 2022	Fakti 4 M 2022
<i>Planifikim, Menaxhimi & Administrim</i>	2,847,771,753	3,108,170,115	1,226,239,516	799,566,095
<i>Ceshtje Financiare & Fiskale</i>	353,136,358	350,990,358	118,000,000	87,458,093
<i>Sherbimet e Policise Vendore</i>	517,064,339	601,964,339	176,700,000	156,532,027
<i>Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile</i>	335,276,174	524,089,041	214,296,863	44,108,048
<i>Mbeshtetja per Zhvillimin Ekonomik</i>	39,000,000	39,000,000	29,000,000	4,352,337
<i>Sherbimi I Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi</i>	69,407,918	69,404,498	27,179,910	19,199,720
<i>Sherbimet Bujqesore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve</i>	275,418,079	294,175,879	110,328,414	56,264,562
<i>Menaxhim I Infrastruktures se Ujitjes & Kullimit</i>	22,506,113	59,510,471	14,053,427	406,960
<i>Administrimi I Pyjeve & Kullotave</i>	10,353,262	11,758,002	7,099,034	2,824,000
<i>Rrjeti Rrugor</i>	2,694,617,454	3,446,093,680	1,168,360,521	304,004,619
<i>Transporti Publik</i>	556,607,185	588,657,585	302,334,000	87,182,317
<i>Projekte Zhvillimi</i>	262,883,520	262,883,520	60,250,000	-
<i>Zhvillimi I Turizmit</i>	15,000,000	20,152,950	12,152,950	1,752,500
<i>Menaxhim I Mbetjeve</i>	2,028,000,000	2,085,858,518	1,075,758,518	437,613,086
<i>Programet e mbrojtjes së mjedisit</i>	9,837,945	9,837,947	5,837,947	3,782,296
<i>Planifikim Urban Vendor</i>	2,535,648,703	3,232,143,892	1,122,209,500	229,140,849
<i>Programet e Zhvillimit</i>	170,000,000	184,165,715	170,665,715	125,048,439
<i>Sherbimet Publike Vendore</i>	4,465,663,798	5,052,086,159	1,556,758,356	492,146,184
<i>Ndricim Rrugesh</i>	348,666,000	384,867,082	234,867,082	87,621,516
<i>Sport dhe Argetim</i>	376,317,457	663,356,743	394,561,194	133,646,376
<i>Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore</i>	557,440,618	723,497,221	344,780,740	147,614,974
<i>Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor</i>	2,750,627,688	2,889,216,151	1,288,855,792	619,250,090
<i>Arsimi I mesem I pergjithshem</i>	1,514,640,263	1,788,327,201	668,479,505	283,207,104
<i>Arsimi profesional</i>	131,835,553	178,687,642	61,522,730	30,948,005

<i>Kujdesi Social per personat e semure & me aftesi te kufizuar</i>	17,070,000	17,070,000	6,000,000	1,582,350
<i>Kujdesi Social per familjet & femijet</i>	297,373,881	300,161,359	114,335,853	51,787,732
<i>Papunesia, Arsim & Aftesim profesional</i>	25,000,000	35,000,000	25,000,000	11,950,000
<i>Strehimi Social</i>	191,800,000	1,272,646,390	155,199,206	30,497,819
<i>Fondi Rezervë</i>	150,000,000	450,000,000	35,000,000	-
<i>Fondi i Kontigjencës</i>	40,000,000	240,000,000	45,000,000	-
TOTAL	23,608,964,061	28,883,772,458	10,770,826,773	4,249,488,099

Në tabelën më poshtë paraqiten fonde të transferuara gjatë kësaj periudhe për Bashkinë Tiranë si rezultat i funksioneve të deleguara për këtë periudhë 4-mujori 2022. Këtu përfshihen fonde që janë deleguar nga qeverisja qendrore nëpërmjet ministrive të linjës për funksionet e deleguara për:

- Gjendjen Civile
- Qendrën Kombëtare të Biznesit
- Ndihmën Ekonomike
- Ndihmë për Personat me Aftësi të Kufizuar
- Kuota për shërbime të ndryshme sociale, Bursa
- Transferime
- Projekte te reja arsimore e kulturore

në lekë

Emertimi	Plan 2022	Plan 4M 2022	Fakti 4M 2022	%
<i>Gjendja Civile</i>	46,721,675	17,990,000	17,323,721	96%
<i>QKB</i>	4,260,000	1,418,000	957,076	67%
<i>Strehimi</i>	200,301,000	200,301,000	196,876,000	98%
<i>Menaxhimi i mbetjeve urbane</i>	180,000,000	180,000,000	178,309,966	99%
<i>Arti dhe Kultura</i>	1,347,597,000	1,347,597,000	-	0%
<i>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</i>	42,361,500	42,361,500	-	0%
<i>Arsimi i mesëm i përgjithshëm</i>	6,230,000	6,230,000	3,266,154	52%
<i>Kujdesi social për familjet dhe femijet / Ndihma Ekonomike</i>	1,350,179,520	1,350,179,520	838,022,225	62%
TOTAL	3,177,650,695	3,146,077,020	1,234,755,142	39%

Fondi i Rezervës dhe Fondi i Kontigjencës, NUK është përdorur gjatë kësaj periudhe.

KAPITULLI II

MONITORIMI*

I

SHPENZIMEVE DHE PRODUKTEVE SIPAS PROGRAMEVE

1. Programi "Planifikim, Menaxhim & Administrim"

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 64%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 93%
- Shpenzime të tjera operative 44%
- Shpenzime kapitale 39%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
Shpenzime personeli	1,614,389,800	508,776,800	473,871,553	93%
Shpenzime te tjera operative	1,226,624,187	637,462,716	282,913,286	44%
Shpenzime kapitale	297,532,882	110,376,754	42,781,256	39%
Totall	3,138,546,869	1,256,616,270	799,566,095	64%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Sherbime të integruara sigurie për godinat, në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe institucione të tjera të Bashkisë Tiranë”, janë planifikuar 54,163,327 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar 48,677,760 lekë ose 90% të planit 4-mujor 2022.
- Projekti “Marrje mjetesh rrugore me qera operationale (leasing) për Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 26,728,000 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar 10,022,400 lekë, ose në masën 37% të planit 4-mujor 2022.
- Projekti “Subvencionimi i lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësave të ujit për kategorinë në nevoje”, janë planifikuar 3,500,000 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar 1,201,233 lekë, ose 34% të planit.
- Kuota anëtarësimi në shoqata e unione janë planifikuar 20,000,000 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar 16,029,673 lekë, ose në masën 80 % të planit 4-mujor 2022.
- Detyrime gjyqësore, janë planifikuar 51,600,118 lekë për 4-mujorin 2022 është realizuar 46,102,555 lekë, ose 89 % të 4-mujorit 2022.
- Investimet për programin e Planifikim Menaxhim Administrim për vitin 2022 janë rreth 26 projekte / investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; software, hardware, mirëmbajtje; të tjera) që menaxhohen nga Aparati i Bashkisë që mbulon këtë funksion realizuar në masën 39% të planit 4-mujor 2022.

Objektivi 1 këtij programi është: Rritja e transparencës dhe imazhit të Bashkisë Tiranë, kundrejt përthithjes së kandidatëve për t’u rekrutuar si nëpunës civilë dhe praktikantëve për të siguruar një edukim sa më të mirë të qytetarëve me tregun e punës dhe përfitimin e krahëve shtesë të forcës punëtore në Bashki në mënyrë eficiente. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

- Produkti 1: Projekti “Fillo me një ide,fito një praktikë pune në Bashkinë Tiranë” për 4-mujorin 2022 është planifikuar 2,500,000 lekë dhe është realizuar 30% e planit 4-mujor.
- Produkti 2: Projekti "Apps -Challenge Tirana" për 4 mujorin 2022 është planifikuar 1,600,000 lekë dhe është realizuar 26% e planit 4 mujor ose 420,000 lek.

2. Programi “Cështje Financiare & Fiskale”


Në këtë program bën pjesë - Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022 krahasuar me buxhetin e periudhës është në masën 74%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit | 94% |
| - Shpenzime të tjera operative | 40% |
| - Shpenzime kapitale | 0% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	261,399,332	85,000,000	80,256,021	94%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	51,000,000	18,000,000	7,202,072	40%
<i>Shpenzime kapitale</i>	38,591,026	15,000,000	-	0%
Total	350,990,358	118,000,000	87,458,093	74%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin ‘Çështje Financiare & Fiskale për vitin 2022 janë 4 projekte / investime që menaxhohen nga Institucioni që mbulon këtë funksion për këtë periudhë raportim nuk ka realizim.

Objektivi për këtë program është: Të asistojë dhe të nxisë tatimpaguesit në mënyrë që të likuidojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor. Të sigurojë zgjerimin e bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit.

Produkti 1: Nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor nëpërmjet informimit për 62,555 tatim pagues aktivë janë shpenzuar 2,821,612 lekë nga 32,039,320 lekë të planifikuar për vitin 2022.

3. Programi “Shërbimet e Policisë Vendore”

Në këtë program bën pjesë - Aparati i Bashkisë.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 89%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 95%
- Shpenzime të tjera operative 51%
- Shpenzime kapitale 0%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	524,817,839	156,773,500	148,712,027	95%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	50,426,500	15,426,500	7,820,000	51%
<i>Shpenzime kapitale</i>	26,720,000	4,500,000	-	0%
Totali	601,964,339	176,700,000	156,532,027	89%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Shërbimet e Policisë Vendore për vitin 2022 janë 6 projekte / investime që menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 4,500,000 lekë për 4-mujorin 2022, nuk ka realizimi për këtë periudhë që raportojmë.

4. Programi “Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Emergjencën Civile.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 7%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 47%
- Shpenzime të tjera operative 3%
- Shpenzime kapitale 0%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	183,813,006	94,128,621	43,988,292	47%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	862,044,575	748,321,117	24,011,342	3%
<i>Shpenzime kapitale</i>	201,384,335	95,000,000	45,716	0%
Totali	1,247,241,916	937,449,738	68,045,350	7%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Demolim dhe evadim i mbetjeve ndërtimore, në Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 3,211,664 lekë për 4-mujorin 2022, nuk ka realizim për këtë periudhë.
- Investimet për programin e Mbrojtjes Nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile për vitin 2022 përbëhet nga 15 projekte/investime të Emergjences Civile dhe 7 projekte/investime të Mbrojtjes nga Zjarri që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion.

5. Programi “Mbështetja per Zhvillimin Ekonomik”


Në këtë program bën pjesë - Aparati i Bashkisë,

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 15%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 15%

				në lekë
Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	39,000,000	29,000,000	4,352,337	15%
Total	39,000,000	29,000,000	4,352,337	15%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për programin “Mbështetja per Zhvillimin Ekonomik” shpenzimet korente për 4-mujorin 2022 janë 3 projekte. Buxheti i planifikuar për këtë program është 29,000,000 lekë për 4-mujorin 2022.

- Projekti “Vlerësim Financiar dhe konsulence Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”, janë planifikuar 6,000,000 lekë për 4-mujorin 2022, nuk ka realizim për këtë periudhë.
- Projekti “Organizata jo-fitimprurese TID”, janë planifikuar 11,000,000 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar 4,352,337 lekë, ose në masën 40% të planit 4-mujor 2022.
- Projekti “Mbështetje financiare(Grant) për biznese të reja, të gjelbërta” të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese "të gjelbërta" duke futur elementë go-green në to’, janë planifikuar 12,000,000 lekë për 4-mujorin 2022, për këtë projekt nuk ka realizim.

6. Programi “Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi”

Ky program është në mbështetje të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së funksionimit të tregjeve në territorin e Bashkisë Tiranë dhe menaxhohet nga Agjencia e Administrimit të Tregjeve me burim nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 71%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- | | |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e Personelit | 95% |
| - Shpenzime të tjera operative | 93% |
| - Shpenzime kapitale | 48% |

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	34,220,658	11,196,070	10,501,236	94%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	30,000,000	10,800,000	8,698,484	81%
<i>Shpenzime kapitale</i>	5,183,840	5,183,840	-	0%
<i>Totall</i>	69,404,498	27,179,910	19,199,720	71%

Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi për vitin 2022 përbëhet nga 4 projekte/investime që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 5,183,840 lekë për 4-mujorin 2022, për të cilat nuk ka realizim.



7. Programi “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve”


Në këtë program bën pjesë Aparati i Bashkisë dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 51%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 93%
- Shpenzime të tjera operative 10%
- Shpenzime kapitale 0%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	174,665,885	56,000,000	51,863,189	93%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	92,282,194	46,188,414	4,401,373	10%
<i>Shpenzime kapitale</i>	27,227,800	8,140,000	-	0%
Totali	294,175,879	110,328,414	56,264,562	51%



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti "Hartimi i planeve të mbarështimit të fondit pyjor dhe kullosor për Ekonominë Pyjore "Pezë", Ekonominë Pyjore "Shesh" dhe Ekonominë Pyjore "Krrabë-Gurrë, janë planifikuar 14,072,414 lekë për 4-mujorin 2022, për të cilin nuk ka realizim.
- Projekti "Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore "Zall-Herr-Priskë" janë planifikuar 6,116,000 lekë për 4-mujorin 2022 për të cilin nuk ka realizim.
- Projekti "Përditësim i "Regjistrimit të fermerëve" për Nja Baldushk janë planifikuar 5,000,000 lekë për 4-mujorin 2022 ,për të cilin nuk ka realizim.
- Investimet për programin e Shërbimeve bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve për vitin 2022 përbëhet nga 9 projekte/investime që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 27,227,800 lekë për 4-mujorin 2022, për të cilat nuk ka realizim për këtë periudhë. Si dhe nga 1 projekt/investim i Aparati të Bashkisë, buxheti i planifikuar është 35,329,293 lekë.

Objektivi i këtij programi është: Inspektimi dhe shërbimet për qytetarët, administrim i thertores publike si dhe mbrojtja e trajtimi i kafshëve endacake. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

- Produkti 1: Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të tjera janë realizuar 7,152 kontrolle dhe inspektime përgjatë kësaj periudhe raportimi nga 18,000 kontrolle dhe inspektime të planifikuara për vitin 2022.

8. Programi “Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit”


Ky program menaxhohet nga Aparati Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (Transferta e Pakushtezuar Sektoriale)

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 3%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 3%
 - Shpenzime kapitale 0%
- në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
Shpenzime të tjera operative	24,181,178	14,053,427	406,960	3%
Shpenzime kapitale	35,329,293	-	-	
Totali	59,510,471	14,053,427	406,960	3%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Shpenzime operative të menaxhuara nga Drejtoria Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik janë planifikuar 14,053,427 lekë për 4-mujorin 2022 dhe realizuar në masën 3% të planit 4-mujor 2022.

Objektivi i këtij programi është: Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e cdo sistemi kullimi dhe vepër mbrojtjeje nga përmytja brenda zonës përkatëse nën shërbim nën mënyrë që të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit dhe të parandalojë përmytjen. Pastron dhe mirëmban kanalet kulluese, mbledhëse, tubat dhe strukturat; Shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit dhe hodrovoret; Kontrollon cilesinë e ujit si dhe mbikëqyr, mirëmban dhe rregullon sistemet kryesore të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje nga 6,340 (ha) nga të cilat janë realizuar për 2,154 (ha) ose 4,122,367 lekë.

Produkti 2: Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim nga 2450 (ha) të planifikuar janë realizuar për 655 (ha) në total shpenzimet për këtë produkt për 4-mujorin 2022 janë në vlerën 2,542,350 lekë.

9. Programi “Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave”

Ky program menaxhohet nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me fonde nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 40%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 40%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	11,758,002	7,099,034	2,824,000	40%
Totali	11,758,002	7,099,034	2,824,000	40%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



10. Programi “Rrjeti Rrugor”


Ky program është në funksion të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve në zonat urbane dhe rurale. Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë si dhe Insitucioni i varësisë Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 26%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e Personelit 96%
- Shpenzime të tjera operative 19%
- Shpenzime kapitale 18%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	në lekë
				Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	374,997,516	117,025,076	112,257,630	96%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	591,300,677	212,442,151	39,489,305	19%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,479,795,487	838,893,294	152,257,684	18%
Totali	3,446,093,680	1,168,360,521	304,004,619	26%



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Menaxhimi dhe mirëmbajtja e sheshit Skenderbej”, është planifikuar 18,000,000 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 17,983,190lekë, ose në masën 99.9% të planit 4-mujor të vitit 2022.
- Projekti i mirëmbajtjes vjetore dhe asistences teknike të Qendrës së Monitorimit e Menaxhimit të Sistemeve të Transportit, është planifikuar 8,652,000 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në masën 43% të planit 4-mujor të vitit 2022.
- Investimet për programin Rrjeti Rrugor për vitin 2022 janë rreth 101 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponencë teknike; të tjera) që menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion, nga të cilat Rikonstruksione, ndërhyrje rehabilituese, ndërtime janë kryer në masën 18% të 4-mujor të vitit 2022.

Objektivi i këtij programi është :Mirëmbajtja e rrugëve kryesore dhe jokryesore me asfaltobeton (sistemim, asfaltim i pjesshëm), mirëmbajtja e trotuareve dhe shesheve publike (sistemime të pjesshme me pllaka, asfalt dhe beton), mirëmbajtja dhe pastrimi i zgavrave dhe kunetave te ujërave të bardha (disiplinimi i ujërave të shiut), fuqizimi dhe modernizimi i ndriçimit publik dhe mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i rrjetit të semaforëve dhe sinjalistikës rrugore. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1 :Rrugë të mirëmbajtura në vit, asfalt nga 98,600 m² të planifikuara janë realizuar 20,754 m² për 4-mujorin 2022.

Produkti 2: Rrugë të mirëmbajtura në vit, troturare nga 23,000 m² të planifikuara janë realizuar 4,929 m² për 4-mujorin 2022.

Produkti 3: Pajisje me sinjalistikë horizontale janë planifikuar rreth 2,325 copë kangjella, birila, grerëza për tu vendosur gjatë këtij viti, për 4-mujorin e pare janë vendosur në total 767 copë kangjella, birila, grerëza ose 4,340,680 lekë të shpenzuar për këtë produkt. Për vijëzimet e rrugëve për 4-mujorin 2022 në total janë realizuar 4,578 ml.

11. Programi “Transporti Publik”

Në këtë program bën pjesë Aparati i Bashkisë si dhe Tirana Parking si Institucion varësie.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 29%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 86%
- Shpenzime të tjera operative 24%
- Shpenzime kapitale 15%
-

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	117,243,774	37,124,000	31,948,406	86%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	245,576,000	181,576,000	43,057,111	24%
<i>Shpenzime kapitale</i>	225,837,811	83,634,000	12,176,800	15%
Totali	588,657,585	302,334,000	87,182,317	29%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Transportit Publik për vitin 2022 janë rreth 25 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikëqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponencë teknike; të tjera) që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 83,634,000 lekë për 4-mujorin 2022, realizuar në masën 15% të planit 4-mujorin 2022.

Objektivi 1 i këtij programi është: Grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Subvencion për shërbimin e transportit qytetës në Bashkinë e Tiranës është një projekt. Plani i planifikuar është në vlerën 136,000,000 lekë nga të cilat janë realizuar 32,617,936 lekë ose 24% e vlerës së planit.

Produkti 2: Matjet periodike të pasagjerëve të transportit publik qytetas është një projekt. Plani i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 3,000,000 lekë, për këtë periudhë raportimi nuk ka realizim.

Produkti 3: Projekti i GPS ne Transportin Publik të qytetit është një projekt. Plani i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 22,500,000 lekë, për këtë periudhë raportimi nuk ka realizim për këtë produkt.

Objektivi 2 i këtij programi është: Shtimi i blloqeve rezident në qytetin e Tiranës me qëllim rritjen e kapaciteteve të parkimit të qytetarëve. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

- Produkti 1: Mirëmbajtja e sipërfaqeve të shesheve të parkimit në total gjatë viti 2022 janë 51829 m² të cilat do të mirëmbahen nga institucioni i varësisë Tirana Parking. Buxheti i planifikuar për këtë viti është në vlerën 183,092,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 18% të vlerës ose në vlerën 32,215,000 lekë.
- Produkti 2: Mirëmbajtja e sistemeve të parkimeve dhe pastrimi buxheti për vitin 2022 është në vlerën 18,228,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 10% ose në vlerën 1,903,000 lekë

12. Programi “Projekte Zhvillimi”


Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.

Gjatë 4-mujorin 2022 për këtë funksion, nuk është kryer asnjë shpenzim. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime kapitale 0%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime kapitale</i>	262,883,520	60,250,000	-	0%
Totali	262,883,520	60,250,000	-	0%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Investimet për programin e Projekte e Zhvillimit per vitin 2022 janë 6 projekte / investime qe menaxhohen nga Aparati i Bashkisë që mbulon këtë funksion. Buxheti i planifikuar per kete program është 262,883,520 leke per vitin 2022, të cilat nuk janë realizuar gjatë periudhës që raportojmë.

13. Programi “Zhvillimi i Turizmit”


Në këtë program përfshihen projekte për zhvillimin e turizmit nga Aparati i Bashkisë.

Gjate 4-mujorit 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 14%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 14%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	20,152,950	12,152,950	1,752,500	14%
Totali	20,152,950	12,152,950	1,752,500	14%



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden Projekte Turizmi është planifikuar 12,152,950 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 1,752,500 lekë, ose në masën 14% të periudhës së raportimit.

14. Programi “Menaxhim i Mbetjeve”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 41%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 41%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	2,085,858,518	1,075,758,518	437,613,086	41%
Totali	2,085,858,518	1,075,758,518	437,613,086	41%



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Pastrimi i Qytetit, është planifikuar 919,443,356 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 437,613,086 lekë, ose në masën 48% të planit 4-mujor 2022.
- Shpenzime për Ndërtimin e Landfillit, Inceneratorit dhe Rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike që është edhe në funksion të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës vendore rajonale, është planifikuar 156,315,162 lekë për 4-mujorin 2022, nuk ka realizim për këtë periudhë raportimi.

15. Programi Planifikimi Urban Vendor


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 18%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit | 91% |
| - Shpenzime të tjera operative | 2% |
| - Shpenzime kapitale | 15% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	169,984,000	54,600,000	49,847,981	91%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	35,809,500	17,609,500	329,422	2%
<i>Shpenzime kapitale</i>	3,691,551,585	1,715,201,193	263,942,585	15%
Totali	3,897,345,085	1,787,410,693	314,119,988	18%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Objekti 1 i këtij programi është Harmonizimin e interesave publike dhe interesave private që do të rezultojë në mbrojtjen e hapësirave publike dhe atyre të gjelbra. Planifikimin e objekteve të shpronësuara si rezultat i ndërtimit të veprave madhore nga Bashkia e Tiranës bazuar në legjislacionin përkatës. Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët; Hartimin e planeve të detajuara vendore për zbërthimin e planit përgjithshëm vendor dhe kontrollit të zhvillimit të vazhdueshëm të hapësirave urbane të qytetit, duke bërë kështu që objekti i shpronësimit të jetë parësor në këtë program:

- Investimet për programin e Planifikimi Urban Vendor për vitin 2022 janë 65 projekte /shpronësime dhe studime që menaxhohen nga Aparati i Bashkisë që mbulon këtë funksion nga të cilat janë realizuar 15 % të planit për këtë periudhë raportimi.

Objektivi 2 i këtij programi është: Inspektimin dhe kontrollin e subjekteve ndërtuese. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Numri i inspektimeve tek të tretët (subjekte private dhe publike) për vitin 2022 janë planifikuar rreth 900 inspektime nga të cilat janë realizuar 169 inspektime për 4-mujorin e pare.

16. Programi “Programet e Zhvillimit”

Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 40%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 35%
- Shpenzime kapitale 40%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	84,165,715	70,665,715	25,048,439	35%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,592,492,847	2,592,492,847	1,048,202,368	40%
Totali	2,676,658,562	2,663,158,562	1,073,250,807	40%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Objektivi i këtij programi është: Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe asamblesë së bashkëpronarëve për krijimin e një skeme efektive bashkë-financimi për përmirësimin e ambienteve në pronësi të përbashkët. Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Fondi i komuniteteve, është planifikuar 64,165,715 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 25,048,439 lekë, ose në masën 39% të planit 4-mujor të vitit 2022.

17. Programi 'Shërbime Publike Vendore'

Në këtë program bëjnë pjesë Institucionet e varësisë si më poshtë:

- Aparati i Bashkisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit
- Agjencia e Parqeve të Rekreacionit
- Agjencia e Shërbimeve Funerale


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 31%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime personeli 86%
- Shpenzime të tjera operative 48%
- Shpenzime kapitale 19%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personell</i>	857,955,512	268,196,952	231,535,211	86%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	551,536,352	191,036,352	92,325,785	48%
<i>Shpenzime kapitale</i>	4,069,163,292	1,524,094,049	287,407,821	19%
Totali	5,478,655,156	1,983,327,353	611,268,817	31%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Shërbimeve Publike Vendore për vitin 2022 janë rreth 151 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponence teknike; të tjera) që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion, realizuar në masën 19% për këtë periudhë raportimi.

Objektivi 1 i këtij programi është: Shtimi i ambjenteve shlodhëse, argëtuese dhe terreneve sportive; Rikonstruksion i objekteve rekreative, sanitare, infopoit, objekteve të shërbimit në parqe. Rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta egzistuese. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

- Produkti 1: Sipërfaqe e gjelbëruar në vit (zgjerimi i hapsirave të gjelbra) m² gjatë 4-mujorit të parë janë shtuar 1,505 m² nga 40,000 m² të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti 2: Rrënjë pemë të mbjella për 4-mujorin e parë të vitit janë mbjellur 11,846 rrënjë nga 30,000 rrënjë të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti 3: Numri i punonjësve në shërbim të aktivitete, kënde lojrash rekreative dhe fushat sportive (nr)) janë planifikuar për këtë vit 94 punonjës ose 54 punonjës më shumë se viti i kaluar, ky numër është rritur nga shtimi i aktiviteteve për Tiranë, shtimi i këndeve të lojrave si dhe fushat sportive , aktualisht janë 62 punonjës.

Objektivi 2 i këtij programi është: Administrimin dhe organizimin e shërbimeve funerale ,pastrimin mirembajtjen dhe ruajtjen e varreve dhe varrezave publike. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sipërfaqe për mirëmbajtjen totale të varrezave në total janë 502,070 m² sipërfaqe të cilat duhen të mirëmbahen gjatë viti 2022, buxheti I planifikuar për këtë product për vitin 2022 është 161,924,115 lek, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 19% ose 31,087,035 lekë

18. Programi “Ndriçim Rrugësh”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 37%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 37%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
Shpenzime te tjera operative	384,867,082	234,867,082	87,621,516	37%
Totali	384,867,082	234,867,082	87,621,516	37%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Objekti i këtij programi është mirëmbajtja dhe ndriçimi i rrugëve dhe ambjenteve publike në territorin e Bashkisë Tiranë. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti1: Sheshe publike të ndriçuara janë planifikuar 7,072 m² sheshe për vitin 2022, për këtë periudhë raportimi sipërfaqja e shesheve të ndriçuara është 1,088 m².

19. Programi “Sport dhe Argetim”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Insitucionet e varësisë si më poshtë:

- Agjencia e Rinisë
- Klubi Sportiv “Tirana”
- Klubi shumësportësh “Partizani” dhe
- Klubi Sportiv “Studenti”
-


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 34%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 71%

- Shpenzime të tjera operative 32%
 - Shpenzime kapitale 0.3%
- në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	74,511,653	29,599,034	21,097,621	71%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	563,429,492	353,029,492	112,518,755	32%
<i>Shpenzime kapitale</i>	25,415,598	11,932,668	30,000	0.3%
Totali	663,356,743	394,561,194	133,646,376	34%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Ky program është në funksion të krijimit dhe mirëmbajtjes të hapësirave sportive dhe organizimit të aktiviteteve për rininë.

Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekte Rinore janë planifikuar 8,791,700 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 2,415,700 lekë, ose realizuar në masën 27.5% të planit 4-mujor 2022.
- Projekte Sportive janë planifikuar 11,000,000 lekë për 4-mujron 2022 dhe është realizuar në vlerën 3,022,500 lekë, ose ne masën 28% të planit.
- Projekti “Tirana Youth Capital” është planifikuar 100,000,000 për vitin 2022 dhe është realizuar në vlerën 50,000,000 lekë, ose realizuar në masën 50% të planit. Ky project paraqitet si një makro program dhe mundësi fantastike që do të zgjasë 365 ditë, gjatë të cilave do i jepet jetë një kalendari projektesh me iniciativa e aktivitete të shumta, të cilat do të mbulojnë një

game të gjerë tematikash e prioritetesh që kanë në qendër rininë, në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian.

- Investimet për programin Sport dhe Argëtim për vitin 2022 janë rreth 10 projekte/investime që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion të realizuara 0.3% gjatë kësaj periudhe raportimi.

20. Programi “Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore”


Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Insitucionet e varësisë si më poshtë:

- Qendra Rinore Ten
- Qendra Kulturore Tirana
- Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Kadare"
- Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tirane
- Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Agolli"
- Galeria e Artit Tirana dhe
- Agjensia e Industrisë Kreative

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 43%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 87%
 - Shpenzime të tjera operative 42%
 - Shpenzime kapitale 0%
- në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Planl 2022	Planl 4M 2022	Faktl 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	109,208,283	33,736,500	29,314,427	87%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	513,136,400	279,926,400	118,300,547	42%
<i>Shpenzime kapitale</i>	101,152,538	31,117,840	-	0%
Totall	723,497,221	344,780,740	147,614,974	43%



Ky program është në funksion të krijimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së projekteve/ambienteve kulturore dhe artistike. Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekte Kulturore janë planifikuar 113,728,252 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 38,610,809 lekë, ose realizuar në masën 34% të planit të periudhës raportuese.
- Shërbimi i Dekorit të Qytetit, janë planifikuar 46,000,000 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 18,607,532 lekë, ose realizuar në masën 40 % të planit 4-mujor 2022.
- Investimet për programin e Trashëgimisë kulturore, Eventet artistike dhe kulturore për vitin 2022 janë rreth 29 projekte/investime që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 101,152,538 lekë për vitin 2022, për të cilën nuk ka realizim për këtë periudhë raportimi.

Objektivi 1 i këtij programi është: Krijimin, realizimin dhe interpretimin e veprave cilësore. mundëson edukimin, shlodhjen dhe argëtimin e të gjitha shtresave dhe grupmoshave të shoqërisë. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

- Produkti 1: Numri i aktiviteteve kulturore, artistike të mbeshetura me fondet e bashkisë janë realizuar 11 aktivite nga 19 aktivitete kulturore, artistike të planifikuara. Aktiviteti “Tre dimra”, “Metrosound” 6 premiera , “Gjyshja ka ikur me cirkun”, “Tullumbaci i kuq”.

21. Programi “Arsimi Baze përfshirë Arsimin Parashkollor”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Institucionet e varësisë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve,
- Shkolla “Luigj Gurakuqi”.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 28%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 61%
- Shpenzime të tjera operative 70%
- Shpenzime kapitale 8%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	1,551,429,017	671,806,832	410,450,282	61%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	621,628,960	207,474,960	146,000,636	70%
<i>Shpenzime kapitale</i>	1,793,799,720	1,487,215,546	112,253,983	8%
Total	3,966,857,697	2,366,497,338	668,704,901	28%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor për vitin 2022 janë rreth 63 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponente teknike; të tjera) që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për investimet për këtë program është 1,793,799,720 lekë për vitin 2022, të cilat janë realizuar në vlerën 112,253,983 lekë ose në masën 8% të planit 4-mujor të vitit 2022.

22. Programi “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”


Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 52%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 62%
- Shpenzime të tjera operative 55%
- Shpenzime kapitale 43%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	644,104,912	273,647,849	170,971,999	62%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	562,915,326	201,915,326	111,202,259	55%
<i>Shpenzime kapitale</i>	777,519,773	389,129,140	168,600,829	43%
Totali	1,984,540,011	864,692,315	450,775,087	52%



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Arsimit të mesëm i përgjithshëm për vitin 2022 janë rreth 34 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponence teknike; të tjera) që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 43% të planit 4-mujor 2022.

Objektivi i këtij programi është: Mirëmbajtje e ambienteve në objektet arsimore parauniversitare mirëmbajtjen, lyerjen, pastrimin e grafitëve të paautorizuara, shkarravinave me përmbajtje anti-kulturore, figurave, reklamave apo ngjitjeve me materiale të ndryshme në sipërfaqet e mbikalimeve, nënkalimeve përfshirë kolonat mbajtëse, muret rrethuese që përbëjnë pjesë të arkitekturës urbanistike, platformat ku janë vendosur monumente artistike, konstruksionet e shatërvaneve, si dhe çdo sipërfaqe tjetër ndërtimore e aksesit publik. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

- Produkti1: Mirëmbajtje e objekteve arsimore para-universitare sipërfaqja totale për tu mirëmbajtur gjatë viti 2022 është 270,200 m², buxheti i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 355,079,880 lekë, për këtë periudhë raportimi janë mirëmbajtur 90,256 m² dhe është shpenzuar 158,938,000 lekë.
- Produkti2: Mirëmbajtje e objekteve arsimore para- shkollore sipërfaqja totale për tu mirëmbajtur gjatë viti 2022 është 50,181 m², buxheti i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 36,270,970 lekë, për këtë periudhë raportimi janë mirëmbajtur 16,830 m² dhe është shpenzuar 12,090,000 lekë.

- Produkti3: Mirëmbajtje e objekteve të tjera publike sipërfaqja totale për tu mirëmbajtur gjatë viti 2022 është 48,550 m² , buxheti i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 58,140,180 lekë, për këtë periudhë raportimi janë mirëmbajtur 16,385 m² dhe është shpenzuar 19,370,000 lekë.

23. Programi “Arsimi Profesional”

Në këtë program bën pjesë Drejtori e Konvikteve të Shkollave të Mesme si institucion varësie.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 50%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 48%
- Shpenzime të tjera operative 88%
- Shpenzime kapitale 0%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personell</i>	103,532,626	53,273,500	25,426,873	48%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	24,879,128	6,249,230	5,521,132	88%
<i>Shpenzime kapitale</i>	50,275,888	2,000,000	-	0%
Total	178,687,642	61,522,730	30,948,005	50%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Objektivi këtij programi është: Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucionerve të arsimit profesional (vetëm konviktet). Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

- Produkti: Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte janë 254 nxënës të akomoduar në konvikte këtë 4-mujor të viti 2022. Për këtë viti janë planifikuar të akomodohen 300 nxënës, buxheti i planifikuar është në vlerën 128,411,754 lekë.

24. Programi “Kujdesi Social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 26%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 26% në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	17,070,000	6,000,000	1,582,350	26%
Totali	17,070,000	6,000,000	1,582,350	26%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Objektivi për këtë program është: Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një

gjymtimi fizik ose mendor. Për arritjen e këtij objekti, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Komisione për pagesa NE+PAK” janë planifikuar 6,000,000 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 1,582,350 lekë, ose në masën 26% të planit 4-mujor 2022.

25. Programi “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Institucionet e varësisë si më poshtë:


- Qendra Sociale Multidisiplinare,
- Qendra Komunitare “Shkozë”,
- Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku” ,
- Qendra Komunitare “Strehëza” ,
- Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhiu” dhe
- Qendra Komunitare e Terrenit

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 46%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit | 84% |
| - Shpenzime të tjera operative | 20% |
| - Shpenzime kapitale | 93% |

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Planit 2022	Planit 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime personeli</i>	132,411,206	42,154,651	35,594,244	84%
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	161,950,233	69,728,202	13,827,610	20%
<i>Shpenzime kapitale</i>	7,098,459	3,751,539	3,487,725	93%
Totali	301,459,898	115,634,392	52,909,579	46%



Për 4-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Mbështetje Sociale në Shërbime për kategoritë në nevojë” janë planifikuar 20,428,510 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 970,002 lekë, ose në masën 5% të planit të periudhës së raportimit.
- Ndihma Ekonomike / Paaftësia janë planifikuar 1,345,138,000 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 838,022,225 lekë, ose në masën 62% të planit.(transferta e kushtëzuar)
- Projekti “Mbrojtja Sociale për kategorinë e familjeve në nevojë të përjashtuara nga skema e NE’ janë planifikuar 3,000,000 lekë për 4-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 1,697,952 lekë, ose në masën 57% të planit të periudhës së raportimit.
- Investimet për programin e Kujdesit social për familjet dhe fëmijët për vitin 2022 janë 19 projekte/investime që menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion dhe janë realizuar në masën 93% të planit 4-mujor të vitit 2022.

Objektivi për këtë program është: Mbështetje sociale, psiko- mediko-emocionale, ligjore, edukative për fëmijët dhe familjet në nevojë , te komuniteteve te ndryshme, shërbimin e mencës, aktivitete të ndryshme për të gjithë llojet e shtresave në nevojë. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

- Produkti 1: Numri total i personave të moshës së tretë të shërbyer në qendrat sociale nga të cilët (rezidencial, ditor) janë 165 të moshuar që ju është ofruar shërbimi në qendrat tona sociale.

- Produkti 2: Numri i personave në situatë rruge të trajtuara janë 209 persona (fëmijë dhe të rritur) buxheti i planifikuar 4,697,797 nga të cilat janë shpenzuar 1,147,850 lekë për këtë periudhë raportimi.
- Produkti 3: Numri i fëmijëve dhe të rinjve me Aftësi të Kufizuar që përfitojnë të gjitha shërbimet ditore pa përfshirë mencën për vitin 2022 është planifikuar tju ofrohet 60 personave nga të cilët për këtë periudhë raportimi e kanë marrë si shërbim 26 persona.

26. Programi “Papunësia, Arsim dhe Aftësim Profesional”

Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.


Gjate 4-mujorit 2022 për këtë funksion, nuk është kryer asnjë shpenzim. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 48%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	35,000,000	25,000,000	11,950,000	48%
Totali	35,000,000	25,000,000	11,950,000	48%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Objektivi 1 është: Fuqizimin ekonomik të grave dhe të rejave të cilat me hapjen dhe zgjerimin e bizneseve të vogla nëpërmjet granteve, zgjedhin të zhvillojnë idetë e tyre inovatore në biznes që gjenerojnë vetëpunësim dhe rritjen e numrit të punësuarve. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti "Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes", është planifikuar 10,000,000 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 4,750,000 lekë.

Objektivi 2 është: Krijimin e lehtësirave për hapjen e vendeve të reja të punës për të rinj të sapo diplomuar pa eksperiencë pune të cilët kanë pritshmëri punësimi dhe integrimi në tregun e punës;- Nxitjen e punësimit të biznesit rinor, nëpërmjet lehtësira në ngritjen e biznesit të vogël. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti "Projekti i fuqizimit të të rinjve dhe të rejave", është planifikuar 15,000,000 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 7,200,000 lekë për këtë periudhë raportimi.

27. Programi "Strehimi Social"

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 20%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 20%
- Shpenzime kapitale 0%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 4M 2022	Fakti 4M 2022	Realizimi ne %
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	185,799,206	155,199,206	30,497,819	20%
<i>Shpenzime kapitale</i>	1,086,847,184	-	-	0%
Totali	1,272,646,390	155,199,206	30,497,819	20%



Objekti i programeve sociale të strehimit është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

- Projekti “Bonus Strehimi”, është planifikuar 70,000,000 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 30,126,928 lekë, ose në masën 43% të planit 4-mujori të vitit 2022.
- Projekti “Bonus strehimi për Trajtimin me pagesë të qirasë për familjet që preken nga zbatimi i projektit të rehabilitimit të segmentit Komuna e Parisit-Rr.Kavajes, është planifikuar në vlerën 13,999,206 lekë për 4-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 370,891 lekë.

KAPITULLI III


ECURIA E BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITET 2019-2022

Trendi i kryerjes së shpenzimeve të buxhetit ndër vite paraqitet si mëposhte, në bazë të klasifikimit ekonomik dhe me të gjitha burimet e financimit në Bashkinë Tiranë:

lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Fakti 4M 2019	Fakti 4M 2020	Fakti 4M 2021	Fakti 4M 2022
<i>Shpenzime personeli</i>	1,634,795,340	1,733,214,593	1,896,724,461	1,945,867,789
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	2,845,753,845	2,583,248,532	3,447,546,087	2,838,308,613
<i>Shpenzime kapitale</i>	1,965,711,840	1,155,427,395	2,189,556,062	2,091,186,767
Totali	6,446,261,025	5,471,890,519	7,533,826,610	6,875,363,170

Si dhe paraqitjen grafike të tyre:



Klasifikimi i shpenzimeve sipas burimeve të financimit vitet 2019 - 2022

Shpenzimet sipas burimeve te financimit	Fakti 4M 2019	Fakti 4M 2020	Fakti 4M 2021	Fakti 4M 2022
<i>Te ardhura BT</i>	3,973,632,922	2,989,101,842	3,402,518,039	3,119,757,963
<i>Transferta e pakushtezuar + sektoriale</i>	1,282,208,854	957,814,049	750,995,795	1,128,379,222
<i>Transferta e Pakushtezuar Sektoriale/Rindertimi</i>			1,836,319,075	1,391,119,929
<i>Transferta e Kushtezuar</i>	1,190,419,249	1,524,904,783	1,543,819,698	1,234,755,142
<i>Nga Donacione</i>		69,845	174,003	1,350,913
Totali	6,446,261,025	5,471,890,519	7,533,826,610	6,875,363,170

Si dhe paraqitjen grafike të tyre:

